



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.66/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.SH “PATRONI” me seli në Zonën Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 80219504 e përfaqësuar sipas autorizimit nga Naim Spahiu avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, me kërkesëpadi për anulimin e vendimit me Nr.Prot:68/4 dhe Nr.Ref.KM-49/24 të datës 29.01.2024 të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës, më datë 05.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesa e paditësit N.T.SH “PATRONI” me seli në Zonën Industrialë Prishtinë-Fushë Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 80219504,
- II. SHTYHET ekzekutimi i vendimit Nr.Prot:68/4 dhe Nr.Ref.KM-49/24 të datës 29.01.2024 të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

A r s y e t i m

Me datë 31.01.2024 paditësi N.T.SH “PATRONI” me seli në Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit 80219504 , e përfaqësuar sipas autorizimit nga Naim Spahiu avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ ndaj të paditurës nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë me kërkesëpadi për anulimin e vendimit Nr.Prot:68/4 dhe Nr.Ref.KM-49/24 të datës 29.01.2024 të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tij.



Paditësi në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartetur ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të atakuar me padi në mënyrë të dhunshme nga e paditura siç është vendosur edhe në dispozitivin e vendimit të kontestuar pa pasur një vendim gjyqësor në lidhje me kontestin përkitazi me Kontratën për Dhënien në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore me nr. 1933/2 të datës 01.01.2018 të lidhur mes të paditësit dhe të paditurës, do i sillte paditësit pashmangshëm dëme vështirë të pariparueshme pasi që paditësi në paligjshmërinë e marr në shfrytëzim ka investuar ne vlera të mëdha financiare, duke ndërtuar pompë të derivateve dhe restaurant, ka të punësuar një numër të madh të punëtorëve ku e ushtron aktivitetin e tij ekonomik bazuar në kontratën e lidhur me te paditurën dhe këto fakte provohen edhe nga provat e bashkangjitura në këtë kërkesë siç janë fotografitë e pompës së derivateve, nr. i punëtoreve në këtë pikë të derivateve të paditësit, dëshmitë për investimet e kryera etj.

Paditësi konsideron se në këtë rast përbushen të gjitha kriteret ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të parapara me dispozitën e nenit 22 të LKA-së ku thuhet se “me kërkesën e paditësit organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim mund të shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar” pasi që paditësi në kushtet e largimit të dhunshëm dhe kundërligjshëm siç është vendosur me vendimin e kontestuar me datë 01.02.2024 më fillim në ora 12:00h , do të pësonte dëme të jashtëzakonshme, sepse siç shihet në pikën IV të vendimit është vendosur qe lënde e lirimt të pronës është liri nga njerëzit dhe sendet, nga shfrytëzimi i hapësirës publike me sipërfaqe prej 25 ari e cila gjendet në Zonën Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, pronë e MBPZHR-së dhe që ekzekutimi i vendimit do të bëhet nga personat dhe organet kompetente të autorizuara të kësaj Ministrie si dhe me asistimin e Policisë dhe Drejtorisë së Inspektiveve në Komunën e Prishtinës, si dhe gjatë ekzekutimin zyrtarët kompetent do të bëjnë regjistrimin e inventarit-mallit dhe i njëjti do të deponohet në hapësira përkatëse.

Në një situatë të tillë do të dëmtohej edhe pasuria e paditësit, do t'i ndërprenet Aktiviteti Ekonomik në mënyrë të dhunshme, do të mund të rezikohej edhe siguria publike, pasi që aty gjendet e ndërtuar pompa e derivateve dhe çdo veprim i dhunshëm do të mund të prodhonte pasoja të rezikshme për shëndetin e qytetarëve por edhe do të dëmtohej reputacioni i kompanisë. Të gjitha këto dëme nuk do të mund të riparoheshin, pa marrë parasysh epilogun e



mëtutjeshëm të procesit gjyqësor, i cili për paditësin do të jetë anulimi i paligjshëm i vendimit të kontestuar nga gjykata.

Sa i përket kriterit tjeter, konform nenit 22.2 të LKA-s, paditësi deklaron se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim më interesin publik dhe nuk prodhon asnjë pasojë për të paditurën, kjo përfaktin se paditësi e ka në shfrytëzim pronën dhe të njëjtën e paguan qiranë mujore bazuar në Kontratën për Dhënien në Shfrytëzim më Qira të Tokës Bujqësore të datës 01.01.2018, dhe në rast të shkaktimit të ndonjë rast ky lloj dëmi do të kompenzohet në procedurë civile gjyqësore nga e paditura.

Andaj, i propozon gjykatës që të nxjerr Aktvendim me të cilën e aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.SH “PATRONI” me nr. Unik 80219504, të parashtruar kundër vendimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me Nr.Prot:68/4 dhe Nr.Ref:KM-49/24 I datës 29.01.2024, si dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, deri në vendosjen përfundimtare të procedurës.

Me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: “*Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar*”. Po ashtu në paragrin 6 përcaktohet se “*Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrin 2 të këtij nenit*” dhe nenit 27 par. 1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komercale i cili përcakton se “*Jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e një kërkesë për masë të përkohshme ose lehtësim tjetër urgent, në përputhje me ligjet në fuqi, dhoma e shkallës së parë e konsideron dhe vendos për një kërkesë të tillë pa dëgjim të palëve në seancë*”

Bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata pasi vlerësoi propozimin e paditësit, shkresat e lëndës, por edhe përbajtjen e vendimit, dhe konstatoj se me Vendimi Nr.Prot:68/4 dhe Nr.Ref:KM-49/24 I datës 29.01.2024,



të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural paditësit N.T.SH "Patroni" është obliguar të liroj pronën në pajtim me nenin 2 të Kontratës për dhënjen në shfrytëzim të tokës bujqësore të datës 01.01.2018 sipas paralajmërimit të datës 25.10.2023 dhe të datës 11.12.2023. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate kohëzgjatja e qirasë është pesë viti duke filluar nga 01.01.2018 deri me date 31.12.2023, me mundësi vazhdimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që paditësi e ka argumentuar faktin se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej, dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Gjykata vlerëson se paditësi ushtron veprimtarinë ekonomike me aktivitet Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar – shitje më pakicë të themeluar qysh nga viti 2000, paditësi gjatë periudhës prej 5 (pesë) vitesh në bazë të Kontratës për dhënien në shfrytëzim të patundshmërisë P-71914059-02916-22 sipas kontratës të lidhur me datë 15.09.2013 dhe Kontratës me nr. 1933/2 të datës 29.01.2018 të lidhur mes të paditësit dhe të paditurës, ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar do ti sillte dëm vështirë të riparueshme paditësit pasi që paditësi në paluajtshmërinë e marr në shfrytëzim ka investuar duke ndërtuar pompë të derivateve dhe restaurant, ka të punësuar punëtorë te cilët marrin pagë nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik të paditësit bazuar në kontratën e lidhur me te paditurën.

Prandaj gjykata vlerëson se në rast të ekzekutimit të vendimit të kontestuar paditësit do ti pamundësohej realizimin e fitimeve nga aktiviteti i tij ekonomik, e rrjedhimisht kjo do të ndikonte edhe në ndërprerjen e të ardhurave financiare për të punësuarit në këtë ndërmarrje. Si pasojë me ekzekutimin e vendimit të kontestuar do të shkaktohej dëmi i pariparueshëm pasi që paditësi nuk do të kishte mundësi për kthim të investimeve në gjendjen e mëparshme.

Gjykata po ashtu vlerësoi se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe palës kundërshtare nuk i shkakton ndonjë dëm pasi që paditësi do të vazhdoj të paguaj kompensimin të paditurit në emër të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme sipas obligimeve kontraktuale deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në gjykatë lidhur me çështjen kryesore sipas kërkësëpadisë.

Andaj, gjykata vlerësoj se në rastin konkret janë përbushur në mënyrë kumulative kushtet ligjore që të aprovohet propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kontestuar prandaj



për ta shmangur rrezikun e këtyre pasojave në rast të ekzekutimit të vendimeve të lartcekur dhe duke pasur parasysh faktin se shtyrja e ekzekutimit të tyre nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe palës kundërshtare nuk i shkakton ndonjë dëm, gjykata vendosi ta aprovoj kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve derisa gjykata të vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të kontestuar përkitazi me padinë e paditësi ku do të shqyrtohen të ligjshmëria e vendimit të kontestuar.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 dhe nenit 27 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.66/24 datë 05.02.2024



Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate